



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 42

Prishtinë, më 27. 5. 2019, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Lutfi Zharku, Salih Salihu, Etem Arifi dhe Danush Ademi.

Munguan: Andin Hoti, Ganimete Musliu, Liburn Aliu, Salih Zyba dhe Sergjan Mitroviç.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 2.5.2019;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
4. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës, e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se komisioni, me 6 vota për, miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të komisionit nga mbledhja e mbajtur më 18.4.2019

Kryetari konstatoi se komisioni, me 6 vota për, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 2.5.2019.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Kryetari Nitaj, fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe tha se për Projektligjin nr. 06/L-100 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, amendamentet janë përgatitur, së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit, sponsorizuese e projektligjit. Gjithashtu, në grup punues, ku kanë qenë të gjithë deputetët e komisionit, për dy ditë është shqyrtuar edhe gjatë vizitës në Mal të Zi, si dhe janë përgatitur amendamentet, ku pjesa dërmuese e tyre janë teknike e gjuhësore, pastaj e hapi debatin duke ua dhënë fjalën anëtarëve të komisionit.

Pasi që nuk kishte diskutues, ai ftoi anëtarët e komisionit për votim dhe konstatoi se komisioni, me 6 vota për, miratoi amendamentet dhe vendosi që komisioneve të përhershme t'ua paraqesë, këtë:

Raport me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-100 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Amendamenti 1

Neni 1, paragrafi 2, ndryshohet si vijon:

“Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2008/50/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 21 maj 2008 për cilësinë e ajrit dhe ajër të pastër në Evropë; Direktivën 2004/107/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 15 dhjetor 2004 për arsenik, kadmium, merkur, nikel dhe hidrokarbure aromatike policiklike në ajrin mjedisor; Direktivën 2010/75/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 24 dhjetor 2010 mbi emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes) dhe Direktivën 2001/81/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 23 tetor 2001 për kufijtë kombëtar për ndotës të caktuar atmosferikë.”

Amendamenti 2

Neni 3, nën paragrafi 1.3. dhe në tërë tekstin e projektligjit, fjala: **“direkt”** zëvendësohet me **“drejtpërdrejt”** dhe fjala **“indirekt”**, zëvendësohet me **“tërthortë”**.

Nënparagrafi 1.23, fjala **“kamdmiumi”**, zëvendësohet me **“kadmiumi”** dhe para fjalës **“këtyre”** germa **“e”**, zëvendësohet me **“të”**.

Nënparagrafi 1.47, fjala **“Mjedis”**, zëvendësohet me **“së Mjedisit”**.

Nënparagrafi 1.49, ndryshohet si vijon: **“DMMU- Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave”**.

Nënparagrafi 1.51 dhe në tërë tekstin e projektligjit, termi **“AKA – Agjencia e Kosovës për Akreditim”**, zëvendësohet me **“DAK- Drejtoria e përgjithshme e Akreditimit e Kosovës”**, si dhe shkurtesa **“AKA”**, zëvendësohet me **“DAK”**.

Pas nënparagrafit 1.52, shtohet një nënparagraf i ri: **“Ndërmarrësi - pronari i kompanisë”**.

Amendamenti 3

Neni 5, paragrafi 3, bëhet paragrafi 2 dhe vazhdon numërimi.

Paragrafi 4 dhe në tërë tekstin e projektligjit, fjala **“kontinuale”**, zëvendësohet me **“vazhdueshme”**, ndërsa në rreshtin e gjashtë **“laboratori referent”**, zëvendësohet me **“Ministria/IHMK”**.

Paragrafi 5, **“laboratori referent”**, zëvendësohen me **“Ministria”**.

Amendamenti 4

Neni 6, paragrafi 3 dhe 4, pas fjalës **“kufitare”**, shtohet **“të emisioneve”**.

Amendamenti 5

Neni 9, paragrafi 1, ndryshohet si vijon: **“Rrjeti shtetëror për Monitorimin e Përhershëm të Cilësisë së Ajrit vendoset në zona dhe aglomerate të Republikës së Kosovës”,** paragrafi 2, pas fjalës **“ajrit”**, fshihet **“në zona dhe aglomerate”**.

Amendamenti 6

Neni 12, paragrafi 1, në rreshtin e gjashtëmbëdhjetë, para fjalës **“ajrit”**, shtohet **“cilësisë së”**, paragrafi 2, në fillim të paragrafit, nyja e përparme **“së”**, zëvendësohet me **“të”** dhe në fund të paragrafit, pas fjalës **“emisioneve”**, ndryshohet si vijon: **“Ministri e përcakton me akt nënligjor, sipas nenit 6 paragrafi 2 të këtij ligji”**.

Paragrafi 3 dhe në tërë tekstin e projektligjit, shkurtesa **“DPA”**, zëvendësohet me **“DAK”**.

Amendamenti 7

Neni 13, paragrafi 2, në fillim, fjala **“Vlerësimi i”**, bëhet **“Vlerësimin e”**.
paragrafi 3, në rreshtin e dytë, pas fjalës **“dioksidit”**, germa **“i”** bëhet **“të”**.

Amendamenti 8

Neni 22, në mes të paragrafit 1 dhe 2, fshihet **“x”**.

Amendamenti 9

Neni 24, paragrafi 1, në rreshtin e dytë dhe të fundit, fjala **“mund ti”**, zëvendësohet me **“i”**.

Amendamenti 10

Neni 26, nënparagrafi 2.2, **“ti”**, zëvendësohet me **“t’i”**.

Amendamenti 11

Neni 27, nënparagrafi 1.4, fjala **“aktivitet”**, bëhet **“aktivitetet”**.

Paragrafi 4, numri **“pesë (5)”**, zëvendësohet me **“tre (3)”**, ndërsa në fund të paragrafit, shtohet: **“nëse nuk rregullohet ndryshe me ndonjë akt ligjor.”**

Paragrafi 8, fshihet numri **“tri (3)”**, ndërsa fjala **“vite”**, bëhet **“vit”**.

Amendamenti 12

Neni 28, paragrafi 1, në rreshtin e pestë, numri **“pesë (5)”**, zëvendësohet me **“tre (3)”**.

Paragrafi 6 dhe 7, fjala: **“Plani”**, bëhet **“Planin”**.

Amendamenti 13

Neni 29, paragrafi 3, në rreshtin e gjashtë, pas lidhëzës **“dhe”**, pjesa e fjalisë: **“ti parasheh edhe veprimtaritë specifike”**, zëvendësohet me **“veprimtaritë tjera specifike”**.

Amendamenti 14

Neni 30, paragrafi 1, në rreshtin e parafundit, numri **“katër (4)”**, zëvendësohet me **“tre (3)”**.

Nënparagrafi 2.3, pas fjalës **“mbrojtjen”**, shtohet germa **“e”**.

Amendamenti 15

Neni 31, paragrafi 1, ndryshohet si vijon:

“Ministria është e obliguar që në ueb faqen e saj të publikojë draftin final të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit nga neni 27 dhe planit nga neni 29 të këtij ligji, raportin nga neni 30, paragrafi 3 i këtij ligji, si dhe komunat, draftin final të planit të veprimit nga neni 28 dhe 29 të këtij ligji dhe raportin nga neni 30, paragrafi 4 të këtij ligji, duhet t’i publikojnë në ueb faqet e tyre për marrjen e mendimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve eventuale.”

Amendamenti 16

Neni 32, titulli i nenit, ndryshohet: **“Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve”**.

Paragrafi 1 dhe 4, shkurtesa **“MË”**, zëvendësohet me **“MW”**.

Paragrafi 2, në rreshtin e tetë, fshihet fjala **“Këto”**.

Amendamenti 17

Neni 34, paragrafi 1, në rreshtin e parafundit **“të i”**, bëhet **“t’i”**.

Paragrafi 3 dhe 7, fjala **“bashkëngjit”**, bëhet **“bashkëngjet”**.

Paragrafi 8, numri **“tetëmbëdhjetë (18)”**, zëvendësohet me **“njëzet e katër (24)”**.

Amendamenti 18

Neni 35, në fund fjalët: **“komfor nenit”**, zëvendësohet me **“në përputhje me nenin”**.

Amendamenti 19

Neni 36, paragrafi 1, **“4 vite”**, bëhet **“katër (4) vjet**

paragrafi 3, në rreshtin e tretë, pas fjalës **“sjell”**, shtohet **“Ministrisë”**, në rreshtin e katërt, fshihet fjala **“Ministrisë”**, kurse fjala **“ndonjë vit”**, zëvendësohet me **“çdo vit”**.

Amendamenti 20

Neni 38, paragrafi 1, në fund, shkurtesa **“/ IHMK”**, zëvendësohet me **“në kuadër të IHMK-së”**, nënparagrafi 2.1, në fund, germa **“ë”** bëhet **“në”**.

Nënparagrafi 2.2, ndryshohet: **“bashkëpunon me laboratorët tjerë referentë të shteteve të Bashkimit Evropian, për monitorimin e cilësisë së ajrit, me qëllim të sigurimit të krahasueshmërisë dhe cilësisë së matjes;”**.

Nënparagrafi 2.5, në fund, fjalët: **“komfor standardeve të”**, zëvendësohen me **“në përputhje me standardet e”**.

Paragrafi 3, në rreshtin e dytë, **“iu”** bëhet **“i”**, dhe në rreshtin e katërt, fjala **“ajr”**, bëhet **“ajër”**, paragrafi 5, fshihet.

Paragrafi 6, pas fjalës **“punës”**, fshihet pjesa tjetër e fjalisë.

Amendamenti 21

Neni 40, paragrafi 1, në rreshtin e dytë, fshihet **“të”**.

paragrafi 3, fshihet

Amendamenti 22

Neni 44, nën paragrafi 2.12, në rreshtin e tretë, fshihet fjala **“aktiviteteve”**.

Amendamenti 23

Neni 47, nënparagrafi 2.2, në fund, lidhëza **“dhe”** fshihet.

Amendamenti 24

Neni 48, paragrafi 2, ndryshohet si vijon:

2. Raporti nga paragrafi 1. i këtij neni hartohet në bazë të aktit nënligjor të përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1 të këtij ligji.

2.1. Raporti përmban: pasqyrën e nivelit të ndotësve në ajër, të cilët tejkalojnë vlerën kufitare, vlerën e synuar, objektivat afatgjate, prapun e informimit dhe prapun e paralajmërimit, për kohën e caktuar dhe të gjitha të dhënat e nevojshme të përcaktuara në nenin 47, paragrafi 2 dhe 4 të këtij ligji. Këto të dhëna ndërlidhen me vlerësimin përmbledhës të efekteve të këtyre tejkalimeve, në shëndetin e njeriut dhe vegjetacion.

Amendamenti 25

Neni 50, në rreshtin e gjashtë, fjalët: **“besuar atyre”**, zëvendësohet me **“besueshëm”**.

Amendamenti 26

Neni 52, nënparagrafi 2.4, pas fjalës **“burimet”**, shtohet germa **“e”**.

Nënparagrafi 2.9, fjala **“integrua”**, bëhet **“integruar”**.

Nënparagrafi 2.11, fjala **“materie”**, bëhet **“materiet”**.

Amendamenti 27

Neni 53, në fund, pas fjalës **“personi”**, shtohet germa **“i”**.

Amendamenti 28

Neni 54, paragrafi 1, pas fjalës **“përmbushjen”**, shtohet germa **“e”**.

Amendamenti 29

Neni 55, paragrafi 4, në fund, fjala **“shëndetit të”**, zëvendësohet me **“shëndetin e”**.

Amendamenti 30

Neni 56, paragrafi 5, në rreshtin e tretë, pas numrit **“2”**, lidhëza **“dhe”**, zëvendësohet me **“,”**.

Paragrafi 6, në fund, fjalët: **“pranë gjykatës”**, zëvendësohen me **“në gjykatën”**.

Amendamenti 31

Neni 57, paragrafi 3, pas fjalës **“urdhër”**, germa **“i”** zëvendësohet me **“të”**.

Amendamenti 32

Neni 59, paragrafi 2, fjalët: **“mund të i lëshoi”**, zëvendësohet me **“i lëshon”**.

Paragrafi 3, fjalët: **“mund të shqiptoi”**, zëvendësohet me **“shqipton”**.

Paragrafi 4, fjala **“urdhëresës”**, bëhet **“urdhëresës”** dhe **“të i”** bëhet **“t’i”**.

Paragrafi 5, në fund, fshihet fjala **“palës”**.

Paragrafi 6, në fund, fjalët: **“pranë gjykatës”**, zëvendësohet me **“në gjykatën”**.

Amendamenti 33

Neni 60, paragrafi 1, ndryshohet si vijon:

“Për të siguruar zbatimin e masave nga neni 55, paragrafi 4 dhe 7, neni 58, paragrafi 4, neni 59, paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij ligji, inspektori duhet t’i vulosë/ bllobon hapësirat e punës, hapësirat dhe stabilimentet.”

Amendamenti 34

Neni 61, paragrafi 1, në rreshtin e pestë, fjala **“zbatim”**, bëhet **“zbatimin”**.

Paragrafi 4, fjalët **“pranë gjykatës”**, zëvendësohet me **“në gjykatën”**.

Amendamenti 35

Neni 62, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2, para fjalës **“emetoi”**, shtohet **“të”**.

Nënparagrafi 1.7, fjalët: **“nuk respektohen në afatet e duhura”**, zëvendësohet me **“nëse nuk respektohen afatet kohore”**.

Amendamenti 36

Neni 63, nënparagrafi 1.2, në fund: **“1.1 këtij ligji”**, zëvendësohet me **“3.1 të këtij ligji”**.

Nënparagrafët: 1.3; 1.4; 1.5; 1.6; 1.9 dhe 1.14, në fund, para fjalës **“këtij”**, shtohet **“të”**.

Nënparagrafi, 1.7; 1.8 dhe 1.9, fjala **“ligjor”**, bëhet **“nënligjor”**.

Amendamenti 37

Neni 64, nënparagrafi 1.1, para fjalës **“neni”**, shtohet **“nga”**.

Nënparagrafi 1.3, ndryshohet si vijon: **“nuk vepron me substancat e kontrolluara dhe të reja të gazrave serrë të fluoruara ose varen prej tyre, në mënyrën e përcaktuar në aktin nënligjor nga neni 43, paragrafi 3;”**.

Paragrafi 3, fjala **“mjeshtri”**, zëvendësohet me **“punëtori”** dhe shuma **“njëmijë (1,000.00) ”**, bëhet **“pesëqind (500.00)”**.

Amendamenti 38

Neni 65, nënparagrafi 1.1, fjala **“bjen”**, bëhet **“sjell”**.

Amendamenti 39

Neni 66, në titull, fjala **“mospërmbushje”**, bëhet **“mospërmbushjen”**.

Amendamenti 40

Neni 67, paragrafi 1, fjalët: **“aktit administrativ”**, zëvendësohet me **“vendimit”**.

Amendamenti 41

Numri i kreut **“XVII”**, zëvendësohet me **“XVI”**.

Neni 68, paragrafi 2, në fillim, fjala **“Gjer”**, zëvendësohet me **“Deri”** dhe pas fjalës **“nxjerrjen”**, shtohet germa **“e”**.

4. Të ndryshme

Besa Gaxherri, paraqiti dy kërkesa: së pari kërkoi një takim të përbashkët me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për shqyrtimin e raportit të auditimit të granteve dhe

subvencioneve të Ministrisë së Bujqësisë, pasi që është shqetësuese që janë 8 milionë euro humbje, të dyshuara për subvencione. Së dyti, një përfaqësues i biznesit që merret me kultivimin e kungullit dhe farave dhe një grup bujqish kanë bërë një kërkesë për një takim me komisionin, që të vijë në komision për të shtruar kërkesën e tyre.

Salih Salihu, shprehu shqetësimin për vonesat që po bëhen nga ana e Ministrisë së Bujqësisë për shpalljen e thirrjes për aplikim për grante dhe subvencione. Sipas njohurive, shpallja e periudhës së aplikimit nga Ministria e Bujqësisë për grante, është bërë me vonesë, më 22 maj 2019, ndërkaq shpallja e periudhës së aplikimit për subvencione ende nuk është bërë. Kjo vonesë është e pajustificueshme, ngase prek të gjithë fermerët, të cilët në vend që në këto periudha kohore të jenë në fushë, ata duhet të merren me rregullimin e aplikacioneve. Ai kërkoi që komisioni t'i drejtohet Ministrisë së Bujqësisë, me një shkresë dhe të shprehë shqetësimin për këto vonesa.

Kryetari, në fund, konstatoi:

Për takimin e përbashkët me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, tha se ishte dakorduar me kryetarin e këtij komisioni, që të premten, më 24 maj, të mbahej takim i përbashkët me këtë temë, por ministrja e Bujqësisë, edhe pse kishte deklaruar se do të raportojë, për shkak të obligimeve të saj e ka shtyrë parimisht për datë 3 qershor 2019. Paraprakisht, raporti do t'u shpërndahet deputetëve dhe për çdo ndryshim eventual të kësaj agjende do të njoftoheni me kohë.

Për përfaqësuesit e biznesit që merren me kultivimin e kungullit dhe farave, duhet kontaktuar dhe ai të dërgojë një kërkesë, paraprakisht, dhe në një nga mbledhjet e ardhshme të ftohet për të shtruar kërkesën në komision.

Për propozimin e deputetit Salih Salihu, propozoi që ai të përgatitë tekstin e kësaj kërkeje dhe pastaj në emër të komisionit t'i dërgohet Ministrisë së Bujqësisë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Muharrem Nitaj